



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO		KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		AGENCY AGAINST CORRUPTION	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	2-0/DPK	Br. Prot.	01-4202/13
Dep.		Prot No.	
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	06.12.2013
Nr. pages		Date	
PRISTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.12.2013, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3051/13, për z. Gani Shabani – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Gani Shabani – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat Ordinanca Neuropsikiatrike “Psychomega”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Shabani është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 14.10.2013). Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë në të cilin është njoftuar për situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Shabani, është pajtuar me situatën në të cilën ndodhet dhe ka deklaruar se nuk ka qenë i informuar, e as nuk ka pasur njohuri për këtë situatë që mund të sjellë në gjendje të konfliktit të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Mirëpo, ai është arsyetuar se biznesi është i regjistruar por nuk është funksional dhe premtoi se do të filloj menjëherë procedurën për mbylljen e tij.

Ndërkohë z. Shabani, ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03- 3973/13) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja vullnetare e biznesit privat Ordinanca Neuropsikiatrike “Psychomega”.

Me këtë ai ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

